



Periodiku AMF

Zhvillohet mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian e IOSCO-s

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (IOSCO) zhvilloi më 11 shkurt 2010, Paris, në zyrat qendrore të AMF-së së Francës, mbledhjen e Komitetit Rajonal Evropian (ERC).

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar 2009

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për janarin 2010 arritën shifrën 634,456 mijë lekë, përkundrajt 670,201 mijë lekë të realizuara brenda janarit 2009 ose 5.33% më pak.

Vijon në faqen 3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet mbledhja e Komitetit Teknik të IOPS dhe mbledhja e përbashkët me Grupin e Koordinimit të Pensioneve të IAIS

Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) zhvilloi gjatë periudhës 22-23 shkurt, në Bazel, Zvicër mbledhjen e Komitetit Teknik të IOPS dhe mbledhjen e përbashkët me Grupin e Koordinimit të Pensioneve të IAIS.

Vijon në faqen 6

Zhvillohet seminari rajonal i IOPS-it, mbi mbikëqyrjen e pensioneve për vendet e Evropës Qendrore, Azisë Qendrore dhe Kaukazisë

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve, IOPS në bashkëpunim me Autoritetin e Thesarit të Turqisë zhvilluan gjatë periudhës 25-26 shkurt 2010, në Stamboll, Turqi seminarin rajonal mbi mbikëqyrjen e pensioneve për vendet e Evropës Qendrore, Azisë Qendrore dhe Kaukazisë.

Vijon në faqen 6

Zhvillohet takimi i radhës së Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) zhvilloi në Bazel të Zvicrës, në datat 24 - 26 Shkurt 2010, takimin e radhës në kuadrin e takimeve që kjo shoqatë organizon çdo katër muaj.

Vijon në faqen 7

Edukimi i konsumatorit

Drejtimi i brendshëm i shoqërive të sigurimit dhe administrimi i riskut

(Material i marrë nga botimi i Bankës Botërore "Mbikëqyrja e Bazuar në Risk", me autor Tony Randle, dhjetor 2009)

F. Çfarë lloj sistemesh kontrolli duhet të marrë në shqyrtim mbikëqyrësi?

Përpara se të flasim për sistemet e kontrollit për risqet e veçanta të shpjeguara në rubrikën e mëparshme, vlen të shikojmë rolin e pjesëmarrësve të ndryshëm në procesin e administrimit të riskut.

Vijon në faqen 8

Në këtë numër:

Zhvillohet mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian e IOSCO-s

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

6

Edukimi i konsumatorit

8

Zhvillohet mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian e IOSCO-s

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (IOSCO) zhvilloi më 11 shkurt 2010, Paris, në zyrat qendrore të AMF-së së Francës, mbledhjen e Komitetit Rajonal Evropian (ERC).

Mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian është një moment kyç për anëtarët e IOSCO-s, ku ata marrin informacion dhe shkëmbejnë eksperiencë e pikëpamje mbi aktivitetet e organizatës. Në mbledhjen e radhës së Komitetit Rajonal Evropian, AMF u përfaqësua me Zj. Elisabeta Gjoni, Kryetare.

Problemet që u trajtuan në këtë mbledhje ishin:

- o Marrëveshja Multilaterale e Mirëkuptimit të IOSCO-s.

Gjatë mbledhjes u dha një informacion mbi progresin e aplikantëve në MMoU, anëtarë të ERC-së. Pas një punë intensive për t'u bërë pjesë e Marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit me IOSCO-n, më 11 qershor 2009, gjatë Konferencës së 34-vjetore të Organizatës Ndërkombëtare të Autoriteteve të Letrave me Vlerë (IOSCO) që u mbajt në Tel Aviv, AMF nënshkroi Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit me IOSCO-n. Ky anëtarësim është i një rëndësie të veçantë dhe vjen si kurorëzim i një pune të gjatë e intensive nga ana e AMF-së, shoqëruar me një proces të gjatë verifikimi, i cili solli nevojën e hartimit të një sërë aktesh rregullative. Kjo gjë hap rrugën e madhe të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me institucionet homologe në mbarë botën, duke shënuar një hap të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të tregut të letrave me vlerë në Shqipëri.

Kryetari i Komitetit të Zbatimit të Task Force, (ITF) Z. Tessier, bëri një prezantim mbi një rishikim të parimeve të IOSCO-s, mbi të cilën diskutuan

anëtarët e komitetit dhe shkëmbyen pikëpamjet. Këto ndryshime kanë një rëndësi të madhe, pasi janë etapa për kalimin në vlerësime ndërkombëtare të rregullatoreve të letrave me vlerë.

Sekretariati i IOSCO-s, prezantoi publikimet më të fundit që kishin të bënin me zbatueshmërinë në kuadrin e MMoU-së, shërbimet e auditit, tregjet në zhvillim, produktet e tregjet e parregulluara, etj. Më konkretisht disa nga publikimet më të fundit të IOSCO-s janë :

- o IOSCO kompletion kuadrin e përgjithshëm rregullator në luftën kundër abuzimeve në tregjet ndërkufitare;
- o Deklarata e Joint Forum mbi një rishikim të natyrës së diferencuar dhe mundësive të rregullimit financiar;
- o Materiale të IOSCO-s për zvogëlimin e konfliktit të interesit;
- o Publikime të IOSCO-s mbi standardet rregullatore për fondet në mbrojtjen e investimeve;
- o Rekomandime mbi produktet dhe tregjet financiare të parregulluara;
- o Raport i Komitetit Teknik të IOSCO-s mbi disa principe dhe rëndësia e paraqitjes së shënimeve shpjeguese;
- o Raport i Komitetit të Tregjeve në Zhvillim mbi zbatimin dhe përgjigjen ndaj krizës globale financiare të këtyre tregjeve;
- o Raport i Komitetit teknik në lidhje me komunikimet me auditorin.

Kryetari i Komitetit Evropian të Rregullatorëve të Letrave me Vlerë (CESR), Z. Eddy Wymeersch, një komitet i pavarur, që ka si qëllim të koordinojë punën e rregullatorëve të letrave me vlerë dhe të

veprojë si një grup këshillues ndërmjetës me Komisionin Evropian, mbajti një raport mbi reformën në arkitekturën Evropiane të mbikëqyrjes financiare. Ai informoi anëtarët, se Komisioni Evropian, adoptoi propozimet legjislative të bëra për krijimin e Bordit Evropian të Riskut Sistemik (ESRB) dhe Sistemin Evropian të Mbikëqyrësve Financiarë (ESFB). Tashmë, 3 komitetet ekzistuese të mbikëqyrjes do të zëvendësohen nga 3 Autoritete të reja Mbikëqyrëse Evropiane që janë: Autoriteti Evropian Bankar (EBA), Autoriteti i Pensionsve dhe Sigurimeve Evropiane (EIOPA) dhe ndërkohë krahas këtyre 2 autoriteteve, anëtarët u njohën me propozimin e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian mbi krijimin e një Autoriteti të ri i quajtur *European Securities and Markets Authority*, (ESMA), Autoriteti Evropian i Letrave me Vlerë dhe Tregjeve. Funkcionimi i tyre mbështetet në të gjithë funksionet e komiteteve të mëparshme, të cilave ju shtohen detyrat e mëposhtme:

- të zhvillojë propozimet për standarde teknike që i kalojnë KE për nënshkrim;
- të zgjidhë rastet specifike të mosmarrëveshjeve midis mbikëqyrësve të vendeve të ndryshme, si dhe;
- të kontribuojë në zbatimin e vazhdueshëm të rregullave në komunitet.

Anëtarët e Komitetit Rajonal Evropian, përmes diskutimeve të dobishme treguan mundësitë për lehtësimin e përafrimeve të rregullatorëve midis vendeve jo anëtare të BE-së (rasti i Shqipërisë) me ato të vendeve të Bashkimit Evropian. Temë e diskutimeve ishim edhe punët në vazhdim të IOSCO-s.

Në fund të Mbledhjes pati diskutime midis pjesëmarrësve për zhvillimet më të rëndësishme të vendeve të tyre, si dhe u prezantuan prioritetet e ERC për dy vitet e ardhshme. Kryetarja e AMF-së, Zj. Gjoni, informoi pjesëmarrësit mbi

zhvillimet e fundit në tregun e Letrave me Vlerë të Shqipërisë, si dhe për ndryshimet ligjore në përputhje me direktivat e BE-së dhe kryesisht dy ligjet e aprovuara së fundmi: Ligjin “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore” dhe Ligjin “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura


Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për janarin 2010 arritën shifrën 634,456 mijë lekë, përkundrajt 670,201 mijë lekë të realizuara brenda janarit 2009 ose 5.33% më pak.


Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 55.00% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 45.00% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme, primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një ulje në masën 18.24% të sigurimeve të Jetës dhe 3.88% të sigurimeve të Jo-Jetës. 91.26% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës dhe 8.74% u gjenerua nga veprimtari e Jetës.

Gjatë janarit 2010 u nënshkruan rreth 41,309 kontrata sigurimi, ose rreth 25.08% më pak se në vitin 2009.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar 2010




Struktura e tregut të sigurimeve, janar 2010



Volumi i primit të shkruar bruto, janar (2009-2010)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2009	2010
Janar		
A) Sigurim i Jetës	67,835	55,461
B) Sigurim i Jo-Jetës	602,367	578,994
<i>Nga këto:</i>		
a) Sigurimi i Detyrueshëm	354,727	285,535
b) Sigurimi Vullnetar	247,640	293,459
TOTAL	670,201	634,456

Volumi i primit të shkruar bruto, janar 2010 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme

Gjatë janarit 2010, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 45.00% të të ardhurave nga primit e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janarin 2010, arritën 211,458 mijë lekë, ose 10.09% më pak se në vitin 2009.

Në janar 2010, primit e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 55,351 mijë lekë, ose rreth 47.48% më pak se në janar 2009.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janarit 2010 arritën në 18,726 mijë lekë, apo 32.36% më shumë se në janar 2009.

Sigurimet vullnetare

Në janar 2010, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 348,920 mijë lekë, ose 10.60% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.



Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 293,459 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 48.11%, të pasuara nga sigurimi kasko me 15.74% dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 18.71% dhe peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar 2010, arritën në 27,745 mijë lekë, ose 3.43% më pak se në janar 2009. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 67.81% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në janar 2010 arritën në rreth 55,461 mijë lekë, ose rreth 18.24% më pak se në janar 2009. Rritja në sigurimet e jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredihënies dhe sigurimit të jetës për efekt kredie.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalfanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 32.25% të primeve.



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 54.43% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar 2010 kapi vlerën 151,378 mijë lekë, ose 69.40% më shumë se në janar 2009. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit të detyrueshëm me 96,298 mijë lekë, apo 63.64% të totalit.

Raporti i ulët dëme / prime tregon se tregu ka shumë për të bërë në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj klientit e publikut në tërësi.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet mbledhja e Komitetit Teknik të IOPS dhe mbledhja e përbashkët me Grupin e Koordinimit të Pensioneve të IAIS

Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) zhvilloi gjatë periudhës 22-23 shkurt, në Bazel, Zvicër mbledhjen e Komitetit Teknik të IOPS dhe mbledhjen e përbashkët me Grupin e Koordinimit të Pensioneve të IAIS.

Gjatë mbledhjes u diskutua mbi parime dhe udhëzues për një rishikim të vetëvlerësimit (self assesment) ku përfaqësues nga autoritete homologe, si: Irlanda, Xhamaika, Kenia dhe Rumania, bënë prezantimet e tyre mjaft të vlefshme. Në fund të mbledhjes sekretariati i IOPS-it prezantoi raportin përmbledhës.

Një ndër çështjet e rëndësishme të trajtuara, ishte prezantimi i përbashkët nga sekretariati i IOPS dhe OECD mbi disa rishikime të parimeve të IOPS. Në këtë prezantim u dhanë praktikatat me të mira për menaxhimin e riskut në fondet e pensioneve, si dhe u bë një rifreskim i njohjes së pjesëmarrësve me të dhënat e fundit të *moduleve Toolkit*.

Dita e parë u mbyll me mbledhjen e radhës së Komitetit Ekzekutiv. Në këtë Mbledhje anëtarët u njohën me një raport mbi buxhetin e IOPS dhe kuotën vjetore të anëtarësimit të vendosur, një raport mbi zhvillimin e IOPS, RBS Toolkits, si dhe punën në vazhdim mbi plotësimin e bazës së të dhënave të ISSA/IOPS/OECD. Më pas u bë një njohje me anëtarët e rinj të IOPS, një rishikim me lidhjet dhe organizatat e tjera të fushës dhe u dëgjuan propozimet e Toronto Centre mbi organizimin e trajnimeve në sistemin e pensioneve.

Në ditën e dytë u shqyrtuan shumë projekte dhe studime të ndërmarra më parë dhe anëtarët u njohën me ecurinë e stadin e tyre të zhvillimit. U bë prezantim nga Sllovakia mbi mbikëqyrjen e

kontributeve të përcaktuara dhe u dha drafti i një pyetësori mbi rregullimin e mbikëqyrjen e investimeve alternative. Në pasditen e ditës së dytë u mbajt një tavolinë e rrumbullakët, ku u trajtua tema mbi mbikëqyrjen me bazë Risku në sektorin e pensioneve, zhvillimet e fundit, sfidat dhe mësimet e nxjerra nga sektorë të tjerë. Përfaqësues të IOPS dhe IAIS dhanë eksperiencat të vlefshme lidhur me to.

Një moment kyç ishte paraqitja e bashkëpunimit midis IOPS dhe Grupit të Koordinimit të IAIS. Përfaqësuesi i BB diskutoi mbi zbatimin dhe përdorimin e *Toolkit* me bazë risku të Mbikëqyrjes të IOPS, e kombinuar me mësimet e nxjerra nga *Core Curriculum* e IAIS

Sekretariati i IAIS, me përfaqësues Zj. Catherine Lezon, diskutoi për një rishikim të principeve të IOPS dhe IAIS e parë kjo nga të dhënat e IAIS-it.

Një ndër temat e trajtuara më me rëndësi ishte tema mbi mbikëqyrjen e fazës së pagesës (Payout) dhe koordinimi i punës midis mbikëqyrësve të pensioneve dhe sigurimeve. Për një koordinim sa më të mirë të punës midis mbikëqyrësve u dha edhe një shembull MOU për ndarjen e informacionit midis mbikëqyrësve sipas sektorëve.

Në fund u zhvillua tema mbi Mbikëqyrjen me bazë Risku. Të gjitha temat u trajtuan me profesionalizëm dhe tërhoqën vëmendjen dhe interesin e pjesëmarrësve me pyetje e diskutime të shumta.

Zhvillohet seminari rajonal i IOPS-it, mbi mbikëqyrjen e pensioneve për vendet e Evropës Qendrore, Azisë Qendrore dhe Kaukazisë

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve, IOPS në bashkëpunim me Autoritetin e Thesarit të Turqisë zhvilluan gjatë periudhës 25-26 shkurt 2010, në Stamboll, Turqi seminarin rajonal mbi mbikëqyrjen e pensioneve

për vendet e Evropës Qendrore, Azisë Qendrore dhe Kaukazisë.

Në seminar kishte pjesëmarrës të autoriteteve mbikëqyrëse të sistemit të pensioneve të vendeve të lartpërmendura, si dhe anëtarë të IOPS me ekonomi te reja të tregut dhe sistemin e pensioneve në zhvillim, si rasti i Shqipërisë.

Objektivat e seminarit ishin: të ndajë eksperiencat më të mira për një kuptim sa më të plotë dhe një qartësim të rëndësishëm së adaptimit të rrugëve të ndryshme të sigurimit të pensioneve, reformat në sistemin e pensioneve, kuadri ligjor për zbatimin e rregullimeve në fondet e pensioneve, etj. Vendosja e strukturave të forta dhe efçente në mbikëqyrjen e sistemit të pensioneve private është një nga komponentet kyç të reformës në këtë sistem.

Seminari ishte i ndarë sipas sesioneve, ku u diskutua për aplikimin e principeve të IOPS-it, zhvillimet më të fundit në sistemin e pensioneve private dhe zbatimi i krizës globale, adoptimi i mbikëqyrjes me bazë risku, ku u dhanë edhe shembuj nga eksperiencia e vendeve të ndryshme, etj.

Temat që u trajtuan sipas sesioneve përkatëse ishin:

- Njohje me punën e IOPS;
- Zhvillimet e sistemit të pensioneve në rajon;
- Kontributet e përcaktuara, orientimi i tregjeve të pensioneve dhe sfidat e mbikëqyrjes;
- Njohje me Mbikëqyrjen me Bazë Risku;
- Struktura dhe qeverisja e Autoriteteve të Mbikëqyrjes së Pensioneve, ku nga sekretariati i IOPS dhe Autoritetet Mbikëqyrëse të Pensioneve të Hungarisë dhe Ukrainës u dhanë eksperiencia mbi Strukturën dhe Qeverisjen e Pensioneve.

- Reforma në pension, edukimi financiar dhe fushatat e ndërgjegjësimit për sistemin pensione. Nisur nga rëndësia që ka edukimi financiar dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për zhvillimin e reformës në sistemin e pensioneve nga sekretariati i IOPS dhe homologë u dhanë eksperiencia të vlefshme, si dhe u treguan disa nga metodat efikase në këtë drejtim.

Të gjitha temat u trajtuan me profesionalizëm dhe tërthorë vëmendjen dhe interesin e pjesëmarrësve me pyetje e diskutime të shumta.

Zhvillohet takimi i radhës së Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) zhvilloi në Bazel të Zvicrës, në datat 24-26 Shkurt 2010, takimin e radhës në kuadrin e takimeve që kjo shoqatë organizon çdo katër muaj.

Gjatë këtyre tre ditëve u organizuan takime dhe prezantime mjaft intensive, të cilat patën si objektiv të pari, azhornimin e anëtarëve dhe vëzhguesve të pranishëm me punët kryer nga grupet e ndryshme të punës së IAIS dhe së dyti, marrjen e vendimeve lidhur me përcaktimin e axhendës së ardhshme dhe ndërmarrjet e veprimeve të mëtejshme të shoqatës. Në këtë takim të IAIS morën pjesë rreth 134 anëtarë dhe 43 vëzhgues.

Grupet e punës organizuan disa seksione informuese me qëllim azhornues. Në këto seksione ishin të pranishëm anëtarë dhe vëzhgues të cilët në fund të prezantimeve shtruan pyetje dhe sugjerime për panelet prezantuese. Me mjaft interes u përcollën prezantimet rreth mbikëqyrjes së grupeve të sigurimeve me shtrirje ndërkombëtare dhe mbikëqyrjes me 'makro-fokus'.

- Paneli i seksionit informues të ComFrom,

Kuadri i Përbashkët i Mbikëqyrjes së Grupeve të Sigurimeve Aktive në nivel ndërkombëtar, prezantoi lidhur me qëllimin, parimet, formën dhe afatet e krijimit të ComFrom, nismës më të re të IAIS. Mbikëqyrja efektive e këtyre Grupeve të sigurimeve me aktivitet ndërkombëtar shikohet nga IAIS si një qasje me mjaft rëndësi, pasi suksesi i saj do të përforconte 'la raison d'etre' të shoqatës, sigurimin e stabilitetit financiar.

- Paneli i seksionit informues të Nënkomitetit të Grupeve të Sigurimit dhe Çështjeve Ndërsëktoriale, prezantoi lidhur me nismat e ndërmarra së fundmi, si dhe punët në proces, të cilat priten për t'u përbushur në periudhën 2010-2011. Edhe ky seksion informues vendosi theksin në rëndësinë e qëllimit dhe parimeve të ComFrom.
- Paneli i seksionit informues të grupit të Stabilitetit Financiar, prezantoi lidhur me Komitetin e Stabilitetit Financiar (FSC), riskun sistematik në sektorin e sigurimeve, si dhe propozimet e FSC-së rreth objektivave të ardhshme dhe rolit të Bordit të Stabilitetit Financiar. Njëra ndër çështjet më të diskutuara në këtë seksion ishte ajo e mbikëqyrjes me 'makro-fokus', e cila nga shumë të pranishëm u cilësua si një mjet i domosdoshëm në përmirësimin e mbikëqyrjes efektive.
- Paneli i seksionit informues të Nënkomitetit të 'Solvency', prezantoi rreth ndryshimeve në strukturën e parimeve bazë të sigurimeve lidhur me 'Solvency' dhe konkretisht rreth draft standardeve të mjaftueshmërisë së kapitalit, menaxhimit të riskut të sipërmarrjeve, modeleve të brendshme dhe investimeve.
- Paneli i seksionit informues të Nënkomitetit të Risigurimeve, prezantoi lidhur me aktivitetet e nëngrupit të njohjes së ndërsjelltë të risigurimeve dhe nëngrupit të transparencës së risigurimeve. Edhe ky seksion informues

theksoi rëndësinë e mbikëqyrjes me makro-fokus.

Nënkomitetet Teknike si dhe Komiteti Ekzekutiv u mbledhën në momente të ndryshme gjatë periudhës tre ditore për të miratuar disa prej projekteve të grupeve të punës por mbi të gjitha për të përcaktuar dhe miratuar angazhimet dhe objektivat e ardhshme të shoqatës.

Në takimin mbyllës të Komitetit Ekzekutiv, datë 26 shkurt, përveç paneleve dhe diskutimeve mjaft të rëndësishme të organizuara në kuadrin e politikbërjes së mëtejshme të IAIS, rëndësi pati edhe pjesëmarrja e Z. Jaime Caruana, Drejtor i Përgjithshëm i BIS, i cili ishte ftuar nga kryetari i Komitetit Ekzekutiv, Z. Braumüller, për të shpjeguar disa prej këndvështrimeve lidhur me stabilitetin financiar dhe riskun sistematik në komunitetin financiar ndërkombëtar. Gjithashtu, në këtë mbledhje u diskutuan për herë të parë rezultatet e një sondazhi, i cili kishte si qëllim mbledhjen dhe studimin e opinionëve të anëtarëve dhe vëzhguesve të IAIS për rolin dhe punët e kryera nga kjo shoqatë. Rezultatet u prezantuan nga një përfaqësues i shoqërisë TNS, e cila kishte marrë përsipër organizimin e këtij sondazhi.

Edukimi i konsumatorit

Vijon nga numri i kaluar...

Drejtimi i brendshëm i shoqërive të sigurimit dhe administrimi i riskut

(Material i marrë nga botimi i Bankës Botërore "Mbikëqyrja e Bazuar në Risk", me autor Tony Randle, dhjetor 2009)

F. Çfarë lloj sistemesh kontrolli duhet të marrë në shqyrtim mbikëqyrësi?

Përpara se të flasim për sistemet e kontrollit për risqet e veçanta të shpjeguara në rubrikën e mëparshme, vlen të shikojmë rolin e

pjesëmarrësve të ndryshëm në procesin e administrimit të riskut.

Roli i *Këshillit të Administrimit* është të përcaktojë preferencën e riskut për siguruesin, të vendosë drejtimin e tij të përgjithshëm dhe të sigurojë që administratorët e ndjekin drejtimin që ka vendosur ai.

Roli i *Administratorëve* është të vendosin në jetë strategjitë dhe drejtimin e përgjithshëm të caktuar nga Këshilli i Administrimit. Administratorët marrin vendime se si duhen arritur këto strategji dhe drejtime dhe vendosin politika dhe procedurat për përcjelljen e tyre të stafi operativ. Administratorët monitorojnë edhe respektimin e këtyre politikave dhe procedurave.

Roli i *Audituesit të Jashtëm* është të sigurojë që siguruesi t'u paraqesë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të operacioneve palëve të interesuara dhe të shprehë mendimin e tij lidhur me respektimin e politikave dhe procedurave të siguruesit.

Audituesi i Brendshëm është përgjegjës përpara Këshillit të Administrimit për të siguruar që administratorët i vendosin në jetë strategjitë dhe udhëzimet e Këshillit të Administrimit dhe që stafi operativ i respekton politikat dhe procedurat e përpiluara nga administratorët. Te disa sigurues, Audituesi i Brendshëm është edhe *Administrator i Riskut*, përgjegjësia e të cilit është të identifikojë risqet dhe të kujdeset që ekzistojnë sistemet e duhura të administrimit të riskut për t'i zbutur këto risqe në nivelin që preferon Këshilli i Administrimit.

Roli i *Aktuarit* është të ofrojë këshilla për pozitën e shëndoshë financiare të siguruesit dhe të sigurojë, sidomos, që risku i sigurimit çmohet dhe zbutet si duhet.

Të gjitha këto role kanë rëndësi qendrore për një administrim të efektshëm të riskut dhe analiza e mënyrës si i mban në kontroll risqet siguruesi nuk mund të jetë e plotë pa një analizë të

mënyrës se si përmbushen këto role.

Risku strategjik

Gjatë shqyrtimit se si mbahet në kontroll risku strategjik, mbikëqyrësit lipset të marrin në shqyrtim një numër faktorësh, në të cilët përfshihen si më poshtë:

- A ka siguruesi një proces formal të planifikimit strategjik dhe, nëse po, ky proces a i merr parasysh pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe risqet e siguruesit?
- Ky proces a kërkon një shqyrtim të risqeve të strategjive të veçanta, kostove të strategjive alternative dhe kapacitetit financiar të siguruesit për t'i vënë në zbatim këto strategji?
- A është i përfshirë Këshilli i Administrimit në procesin e planifikimit strategjik, apo ky proces u është lënë në dorë administratorëve?
- A janë të vlefshme apo të arsyeshme hipotezat mbi të cilat mbështeten strategjitë?
- Cilat mekanizma ekzistojnë për t'i dhënë mundësi Këshillit të Administrimit të monitorojë ecurinë e punës krahasuar me planin strategjik dhe për ta ndryshuar atë, nëse është nevoja?
- A mundet siguruesi t'i ndryshojë ose ndërrojë me lehtësi strategjitë nëse ato nuk sjellin rezultatet e pritura?
- A ka prova se siguruesi ka pasur rënie vlere apo humbje të mëdha në të shkuarën për shkak të nismave të dështuara tregtare?

Risku i drejtimit të brendshëm

Kur shikojnë si mbahet në kontroll risku i drejtimit të brendshëm, në lidhje me Këshillin e Administrimit, mbikëqyrësit duhet të kuptojnë mënyrën si emërohet dhe funksionon Këshilli dhe të mbajnë në konsideratë një sërë faktorësh, si më poshtë:

- A ka një statut formal Këshilli i Administrimit, në të cilin përcaktohet roli i tij dhe bëhet



- dallimi midis këtij roli dhe rolit të administratorëve?
- A janë në aftë dhe të duhur anëtarët e Këshillit të Administrimit? Në këtë kuadër “i aftë” do të thotë që të kenë aftësitë dhe përvojën e duhur për të qenë anëtar i Këshillit të Administrimit ndërsa “i duhur” do të thotë të kenë ndershmërinë e nevojshme për këtë post.
 - A është i aftë kolektivisht Këshilli i Administrimit? A i ka, në grup, të gjitha aftësitë për të qenë një Këshill i efektshëm?
 - A ka anëtar të tij të cilët janë aq të rëndësishëm për suksesin e Këshillit sa që mungesa e tyre do ta bënte jo të efektshëm Këshillin (domethënë, a ekziston risku i “personit kryesor”) dhe çfarë hapash ekzistojnë për trajtimin e këtij risku?
 - A i ka Këshilli proceset adekuate për të trajtuar konfliktet e mundshme dhe faktike të interesit?
 - A ka Këshilli një proces formal për ta vlerësuar në mënyrë periodike ecurinë e atij vetë?

Gjërat që duhen parë për administratorët janë të ngjashme:

- A janë të përcaktuar qartë rolet e administratorëve dhe a përfshijnë këto role një kuadër për raportimin përpara Këshillit të Administrimit?
- A janë të aftë dhe të duhur administratorët?
- A ka administratorë të cilët kanë kaq shumë rëndësi për suksesin e siguruesit sa që mungesa e tyre do të përbënte pengesë për biznesin ose do ta rriste ndjeshëm profilin e riskut të siguruesit?
- A ka një plan zëvendësimi për ekipin e administratorëve (sidomos për ata të cilët paraqesin riskun e personit kyç)?
- A u nënshtrohen administratorët normave të efektshme për konfliktin e interesit?
- A shqyrtohet rregullisht ecuria e administratorëve?
- Sa të efektshëm janë administratorët në komunikimin me stafin operativ dhe në monitorimin e ecurisë së stafit?

- Si ua delegon Këshilli funksionet administratorëve dhe si ia delegojnë administratorët stafit operativ?

Risku juridik

Kur shikojnë se si mbahet në kontroll risku juridik, mbikëqyrësit duhet të marrin një njohuri të përgjithshme të natyrës së kërkesave ligjore të ndryshme që duhet të zbatohet një siguresi. Krijimi i pamjes lidhur me mundësinë e siguruesit për të mbajtur në kontroll riskun juridik nuk u kërkon mbikëqyrësve të kontrollojnë respektimin e ligjeve përkatëse nga siguruesi, kështu që nuk është nevoja për të pasur një njohuri të thelluar të kërkesave ligjore.

Mbikëqyrësit duhet të shikojnë pikat e mëposhtme:

- Çfarë elementesh ekzistojnë që Këshilli dhe Administratorët ta njohin kuadrin ligjor në të cilin ushtron aktivitet siguruesi dhe si i përditësojnë njohuritë e tyre Këshilli dhe Administratorët kur ndryshojnë ligjet?
- Brenda siguruesit, kush e ka rolin për të siguruar respektimin e kërkesave të ndryshme ligjore?
- A funksionon si duhet funksioni i respektimit të ligjeve?
- Si i komunikohen stafit kërkesat ligjore dhe ndryshimet e tyre dhe si trupëzohen ato në politikatat, proceset dhe procedurat?
- A ka dëshmi se siguruesi është penalizuar në të shkuarën se nuk ka respektuar ndonjë kërkesë ligjore?

Risku i likuiditetit

Disa prej çështjeve që duhet të shqyrtojnë mbikëqyrësit kur të krijojnë një ide si e zbusin riskun e likuiditetit siguruesit janë:

- A përbën shqetësim për Këshillin administrimi i riskut të likuiditetit?
- A ka vendosur ndonjë mjet për administrimin

e këtij risku Këshilli (një mjet i zakonshëm do të ishte Komiteti i Aktiveve dhe Pasiveve)?

- A ka vendosur siguruesi një paketë të kënaqshme politikash dhe procedurash për administrimin e riskut të likuiditetit dhe a ka dëshmi se siguruesi i respekton këto politika dhe procedura?
- A bën siguruesi parashikime për nevojat e veta për mjete monetare dhe a bën teste të trysnisë apo teste me skenarë për këto parashikime?
- A ka vendosur masa organizative siguruesi të cilat do t'i jepnin mundësi të merrte financim nga jashtë nëse do t'i duhej mbështetje me likuiditet?
- A ka dëshmi për probleme likuiditeti në të shkuarën?

Për të krijuar një ide të mjaftueshmërisë së këtyre sistemeve të kontrollit, në bazë të një kuadri MBR-je, mbikëqyrësit shqyrtojnë politikat dhe procedurat e siguruesit për t'u bindur që ato funksionojnë dhe që mund të pritët të funksionojnë edhe në skenarët e ndryshëm alternativë. Shpesh, mbikëqyrësit shqyrtojnë punën e audituesve të brendshëm dhe të jashtëm, në kuadër të krijimit të kësaj pamjeje.

Risku i kredisë

Siguruesit duhet të mbajnë në kontroll riskun e kredisë që lind nga marrëveshjet që kanë me klientët (sidomos me shoqëritë e mëdha me sigurime me prime shumë të mëdha), me risiguruesit dhe me institucionet në të cilat investojnë. Të rëndësishme për mbajtjen në kontroll të këtij risku janë një paketë politikash dhe procedurash që rregullojnë mënyrën me të cilën i zgjedh të tretët siguruesi, vendosin dhe mbajnë kufij të zbulimit ndaj të tretëve të veçantë dhe mënyrën si e monitoron siguruesi ecurinë me të tretët. Në kuadër të MBR-së, mbikëqyrësit duhet të analizojnë:

- A janë Këshilli dhe administratorët në dijeni të nevojës për të administruar riskun e kredisë?
- A ka instaluar siguruesi një kuadër që përfshin

politika dhe procedura për administrimin e riskut të kredisë?

- A vendosin politikat dhe procedurat kritere për përzgjedhjen e të tretëve, kufizime për të tretët të veçantë dhe për monitorimin e këtyre të tretëve?
- A shqyrtohet rregullisht respektimi i politikës për riskun e kredisë dhe a i raportohet rregullisht për të Këshillit dhe administratorëve?
- A e pasqyrojnë pasqyrat financiare të periudhave të mëparshme riskun e tepërt të kredisë në të shkuarën përmes provizioneve të larta apo përmes çregjistrimit të shumave të mëdha të llogarive të arkëtueshme?

Edhe këtu, mbikëqyrësit shqyrtojnë mjaftueshmërinë e politikave, kërkojnë dëshmi të respektimit të tyre dhe mund të shikojnë idenë e shqyrtimit të punës së audituesve të jashtëm dhe të brendshëm.

Risku i investimit (Risku i tregut)

Edhe këtu, analiza e riskut të investimit në kuadër të MBR-së përqendrohet te politikat dhe procedurat e siguruesit. Mbikëqyrësit duhet të shikojnë pikat e mëposhtme:

- A janë Këshilli dhe administratorët në dijeni të nevojës për të administruar riskun e investimit?
- A ka instaluar siguruesi një kuadër, politika dhe sisteme për administrimin e këtij risku të cilat, sipas mendimit të mbikëqyrësit, janë adekuate?
- A ka ngritur Këshilli i Administrimit një komitet të investimeve me delegimet e duhura nga Këshilli për përzgjedhjen e mundësive për investime?
- A ka vendosur Këshilli i Administrimit udhëzuesit e duhur për investimet dhe a funksionojnë si duhet ata?
- A përfshin ky kuadër një komitet të duhur (siç është Komiteti i Aktiveve dhe Pasiveve) për mbikëqyrjen e administrimit të këtij risku?

- A janë të duhur nivelet e delegimit për administrimin e riskut?
- A vendos kjo politikë kufizime realiste për riskun e tregut ndaj të cilit mund të zbulohet siguruesi?
- A matet shpesh ecuria e siguruesit kundrejt kufijve të vendosur në politikë dhe, kur kalohen këto kufij, a merren në kohë masa ndreqëse?
- A bëjnë të ditur pasqyrat financiare të periudhave të mëparshme se ka pasur një risk të tepërt tregu në të shkuarën, përmes zërave të tillë si zhvlerësimi i vlerave të investimeve?

Në kuadër të MBR-së, mbikëqyrësit shikojnë mjaftueshmërinë e politikave dhe sistemeve të siguruesit, për t'u bindur që siguruesi i respekton ato.

Risku i sigurimit

Në një kuadër MBR, mbikëqyrësit duhet të kenë në objektiv dy faktorë - si projektohen dhe u vendoset çmimi produkteve dhe si vlerësohen dëmet.

Siguruesi duhet të ndjekë një qasje sistematike, në bazë të së cilës përzgjedh paketën e produkteve të veta dhe u vendos çmimin atyre, për të pasqyruar riskun.

Çështjet specifike që duhen parë janë:

- A janë Këshilli dhe administratorët në dijeni të riskut të sigurimit?
- A kanë vendosur procedura Këshilli dhe Administratorët për përzgjedhjen e linjave të biznesit që do të ofrojnë?
- A i kuptojnë Këshilli dhe Administratorët risqet e linjave të përzgjedhura të biznesit?
- A ka siguruesi një qasje sistematike për vendosjen e çmimeve të produkteve që ofron të cilët të pasqyrojnë risqet bazë?
- A funksionojnë në mënyrë të efektshme këto qasje dhe procedura dhe a shqyrtohen rregullisht ato?

E njëjta logjikë vlen edhe për procesin e administrimit të dëmeve. Sipas qasjes MBR, do të konsiderohej se një sigurues ka sisteme të mira kontrolli në ato raste kur ka politika dhe procedura të shkruara dhe të efektshme për trajtimin si duhet të këtij funksioni. Në shumë raste, siguruesit lidhin kontratë me të tretë për realizimin e këtij funksioni dhe politikat e tij duhet të mbulojnë edhe këta ofrues të tretë të shërbimeve.

Çështjet specifike që shikon një mbikëqyrës:

- A janë Këshilli dhe Administratorët në dijeni të risqeve që ka procesi i administrimit të dëmeve?
- A ka vendosur Këshilli dhe Administratorët sisteme, politika dhe procedura të efektshme për zbutjen e risqeve?
- A janë vënë në shfrytëzim dhe a funksionojnë në mënyrë të efektshme?
- Kur siguruesi ka lidhur kontratë me të tretë për realizimin e procesit të administrimit të dëmeve, a ushtron ai kontroll adekuat mbi veprimtaritë e ofruesit të këtij shërbimi dhe a është e dokumentuar si duhet në një kontratë me fuqi ligjore marrëdhënia midis siguruesit dhe ofruesit të shërbimit?
- Analiza e pasqyrave financiare të periudhave të mëparshme a nxjerr në pah një risk të tepërt sigurimi përmes humbjeve të mëdha në llogarinë teknike?

Një burim informacioni për mbikëqyrësin mund të jetë puna e audituesve të jashtëm dhe të brendshëm dhe e aktuarit.

Risku i veprimtarisë (Risku operacional)

Risku operacional lind nga shumë elemente përbërës të biznesit të siguruesit dhe përfshin, ndër të tjera, drejtimin e burimeve njerëzore, informatikën, proceset e kryera me dorë dhe krimin ekonomik dhe mashtrimin. Ai mbulon edhe ato funksione realizimin e të cilëve siguruesi ua ka kaluar me kontratë të tretëve.

Mbikëqyrësi shikon pikat e mëposhtme:

- A janë Këshilli dhe administratorët në dijeni të riskut operativ dhe të nevojës për të administruar atë?
- A ka vendosur siguruesi politika, procedura dhe sisteme adekuate për zbutjen e këtij risku dhe çfarë vlerësimi ka mbikëqyrësi për cilësinë e këtyre?
- Këto politika, procedura dhe sisteme a funksionojnë në mënyrë të efektshme në praktikë?
- A ka sisteme të mjaftueshme kontrolli lidhur me funksionin e informatikës?
- A mund të dëshmohet që janë të efektshme këto sisteme kontrolli? Shpesh, ia vlen të ekzaminohen provat e evakuimit apo teste të tjera.
- Kur një sigurues u ka kaluar me kontratë të tretëve funksione kyçe, a ka ai kontroll dhe monitorim të efektshëm mbi mënyrën se si pret të funksionojnë ofruesit e shërbimit lidhur me funksionet që ua ka kaluar atyre me kontratë?
- A i ka marrë në konsideratë siguruesi pasojat e kolapsit të sistemeve të tij, a ka plane rezervë dhe një plan të marrjes të vetes në rast emergjence për të administruar çdo kolaps sistemi dhe a testohen rregullisht këto sisteme?
- A ka pasur në të shkuarën incidente kolapsi të sistemeve të rëndësishme apo ndërprerje me rëndësi materiale të aktivitetit tregtar?

Edhe këtu, puna e audituesve të jashtëm dhe të brendshëm dhe e administratorit të riskut mund t'i ndihmojë mbikëqyrësit në analizimin e kësaj fushe.

Vijon në numrin e tjetër...

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, Dh. Hazbiu,
D. Tahiraj, R. Eltari, E. Kokona

